



**REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVA - PREDSIEDNIK**

EKIPI PËRGATITOR PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN  
PRIPREMNI TIM ZA OSNIVANJE KOMISIJE ZA ISTINU I POMIRENJE  
PREPARATORY TEAM FOR THE ESTABLISHMENT OF THE TRUTH AND RECONCILIATION COMMISSION

---

**PROJEKT AKTI NORMATIV NR. XX/2020 PËR KOMISIONIN  
PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN**

(VERSIONI PËR DISKUTIM PUBLIK)<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Në tekstin e mëtejshëm: Ekipi), i emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, SH.T.Z. Hashim Thaçi, me Vendimin Nr. 61/2018, të datës 27.04.2018, ka mandatin që të hartojë aktin normativ për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, si dhe aktet tjera të nevojshme.

Varësisht nga përmbajtja e aktit normative, do të shihet se a do të jetë Ligj i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës apo Statut i cili do të dekretohet nga Presidenti.

Komisionet për të Vërtetën dhe Pajtimin, zakonisht krijohen me Ligj ose me Dekret Presidential. Të dyja mënyrat mund t'i kenë përparësitë dhe mangësitë e veta, ndërsa konteksti vendor, automatikisht mund ta paracakttojë rrugën që është më e mira ose që vërtet kërkohet.

Ky version i aktit normativ është hartuar nga Ekipi, pas një procesi të konsultimeve paraprake, dhe do të jetë subjekt i konsultimit publik dhe gjatë gjithë kohës edhe i përpunimit.

Ekipi, përmes procesit të konsultimit publik, do të sigurojë përfshirjen e komuniteteve, të viktimave dhe të mbijetuarve, institucioneve, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile dhe të mekanizmave ndërkombëtare, me qëllim të mbledhjes së kontributit me të dhënat e nevojshme për finalizimin e këtij akti normativ.

<https://www.president-ksgov.net/sq/ekipi-pergatitor-per-themelimin-e-komisionit-per-te-verteten-dhe-pajtimin>

**KOMENTET:** E-mail: [besim.m.kajtazi@president-ksgov.net](mailto:besim.m.kajtazi@president-ksgov.net) Besim M. Kajtazi - Anëtar i Ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.

## **Republika e Kosovës,**

Duke pranuar faktin se ka ardhur momenti për një paqe të qëndrueshme dhe duke qenë të vetëdijshëm që pajtimi është një proces i gjatë dhe i ngadalshëm;

Duke dëshiruar që të fillojë një proces të rimëkëmbjes shoqërore përmes njohjes të së vërtetës, e cila hap rrugën për të ndërtuar dhe mbajtur një paqe të qëndrueshme;

Duke rikujtuar se populli i Kosovës, ka vuajtur pasojat e së kaluarës së dhunshme strukturore, kulturore dhe ndër njerëzore;

Duke pranuar që viktimat dhe të mbijetuarit e shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë të drejtë të dinë për të vërtetën, për trajtim të drejtë për vuajtjet që kanë përjetuar dhe për një garanci për mos përsëritje;

Me qëllim të themelimit të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Komisioni), i cili do të dokumentojë dhe do të vendosë fakte për shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë së kaluarës së afërt, rikthimin e dinjitetit të viktimave dhe të të mbijetuarve, të kontribuojë në transformimin shoqëror për të tejkaluar pasojat e shkeljeve dhe abuzimeve të pësuar si dhe parandalimin e përsëritjes së tyre;

Me qëllim të themelimit të Komisionit me pavarësi të plotë të veprimit pa kurrfarë ndërhyrje politike apo çfarëdo ndërhyrje tjetër, i cili do të veprojë lirisht pa ndikim ose kontroll të drejtpërdrejtë të cilitdo institucion apo mekanizëm vendor apo ndërkombëtar, pavarësisht përkrahjes që mund të ofrojnë;

Duke qenë të bindur që puna e Komisionit do t'i ndihmojë shoqërisë kosovare për ta kuptuar historinë e kontestuar dhe, duke bërë kështu, t'ia sjellë pranë publikut të gjerë zërat dhe rrëfimet e viktimave dhe të të mbijetuarve, përderisa njohja e së vërtetës favorizon pajtimin;

Me qëllim të dhënies së kontributit në ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme e afatgjata institucionale për të drejtat e njeriut, për demokraci dhe për sundimin e drejtësisë, nëpërmjet rekomandimeve të veçanta për reformën institucionale dhe politike;

Duke u mbështetur në propozimin e Ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit, të emëruar nga Presidenti me Vendimin Nr. 61/2018, të datës 27.04.2018, pas një procesi të konsultimeve gjithëpërfshirëse, duke i bërë të qarta rolin, funksionin por edhe kufizimet e Komisionit, në propozimin e tyre, që u përgjigjet kontekstit të Republikës së Kosovës dhe mundësive të veçanta ekzistuese;

Miratton:

## **AKT NORMATIV NR. XX/2020 PËR KOMISIONIN PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN**

## KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Qëllimi

Ky akt normativ ka për qëllim themelimin, përcaktimin e mandatit, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.

### Neni 2

#### Fushëveprimi

Ky akt normativ zbatohet nga Komisioni, Sekretariati dhe nga të gjithë personat e përfshirë në punën e Komisionit.

### Neni 3

#### Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Akt normativ, kanë këtë kuptim:

1.1. **Anëtar i familjes së ngushtë/Familjar:** bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesorë, fëmijët e adoptuar, prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti, bashkëshortja jashtëmartesore;

1.2. **Baza e të dhënave** – nënkupton bazën e të dhënave për ruajtjen, sistemimin dhe analizimin e dokumentacionit të mbledhur dhe deklaratave që i merr Komisioni;

1.3. **Dëshmitar** - nënkupton një person që dëshmon, ose ka dëshmuar për qëllimet e këtij akti normativ;

1.4. **Drejtor**- Drejtori i Sekretariatit;

1.5. **Invalid civil i luftës** - personi, organizmi i të cilit është dëmtuar si pasojë e plagëve të marra nga armët, sëmundjes së marrë në burgjet apo kampet gjatë luftës, mjeteve shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës për periudhën që është në shqyrtim;

1.6. **Komisioner/e/ët:** kur konteksti nuk nënkupton ndryshe, përfshin Kryekomisionerin/en, zëvendëskryekomisionerët dhe Komisionerët;

1.7. **Komisioni** – Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin;

1.8. **Komisioni i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut** – nënkupton Komisionin funksional të Kuvendit, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, apo Komisionin pasues që merret me shqyrtimin e të gjitha përgjegjësive, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me të drejta e njeriut;

1.9. **Komuniteti i viktimave** - përbëhet nga kategoritë e viktimave të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë periudhës në shqyrtim dhe të cilën Komisioni e njeh si të tillë;

1.10. **Konflikti** - nënkupton edhe periudhën e armiqësive si dhe periudhën kur janë ndërmarrë veprime që kanë rezultuar me kryerjen e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut gjatë periudhës në shqyrtim të Komisionit;

1.11. **Kryerësi i veprës**- personi i cili është gjetur përgjegjës nga Komisioni për shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut apo shkeljen e të drejtës humanitare ndërkombëtare apo personi i cili është dënuar ligjërisht si kryes i krimit, bashkëpunëtor apo pjesëmarrës në shkeljen e rëndë të të drejtave të njeriut;

1.12. **Kuvend** – Kuvendi i Republikës së Kosovës;

1.13. **Lufta** - nënkupton gjendjen e konfliktit të armatosur ndërmjet shteteve të ndryshme apo grupeve të ndryshme brenda një vendi;

1.14. **Periudha në shqyrtim e Komisionit**- nënkupton periudhën siç është përcaktuar në nenin 17 të këtij akti normativ;

1.15. **Person i zhdukur** – Personi- vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët dhe kërkuesit e tij/saj, dhe i cili, në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur si pasojë e armiqësive, konfliktit dhe luftës në Kosovë;

1.16. **Person**- kur nuk ceket ndryshe, nënkupton personat juridikë dhe personat fizikë;

1.17. **Personat Civilë** - janë të gjithë personat të cilët në asnjë kohë nuk ishin të armatosur dhe nuk kanë qenë të angazhuar në struktura apo nuk kanë pasur rol si bashkëpunëtorë apo pjesëmarrës në kryerjen e krimit të luftës apo veprave tjera që paraqesin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë periudhës në shqyrtim të Komisionit;

1.18. **Personeli i Sekretariatit**: kur konteksti nuk nënkupton ndryshe, përfshin drejtorin e Sekretariatit dhe të gjithë të punësuarit dhe të angazhuarit tjerë në një formë apo tjetër në punën e Sekretariatit;

1.19. **President** –Presidenti i Republikës së Kosovës;

1.20. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës;

1.21. **Regjistri Qendror i Personave të Zhdukur** - nënkupton bazën kryesore të të dhënave të mbledhura në lidhje me procesin e kërkimit, gjetjes, identifikimit të personave të zhdukur dhe të drejtave tjera për personin apo familjarët e tij/saj;

1.22. **Reparacion** - nënkupton kthimin e dinjitetit të viktimat përmes masave që kontribuojnë në njohjen e vuajtjeve të tyre, për të kompensuar humbjet e tyre sociale, morale dhe materiale dhe për të rikthyer (restauruar) të drejtat e tyre;

1.23. **Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë/RSFJ**, - shteti që e përbënin gjashtë republika socialiste- Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kroacia, Maqedonia, Sllovenia, Serbia dhe dy krahina autonome: Kosova dhe Vojvodina; dhe e cila de facto ka ekzistuar që nga 29.11.1943, deri në shkatërrimin e saj, ndërkohë duke ndërruar emërtimin disa herë;

1.24. **Sekretariati** - Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit;

1.25. **Shkeljet masive të të drejtave të njeriut** përfshijnë:

- i. vrasjen, rrëmbimin, zhdukjen me forcë, torturën, përdhunimin dhe abuzimin seksual, zhvendosjen e detyruar ose dëbimin, skllavërimin, marrjen peng, heqjen e paligjshme të lirisë ose keqtrajtimin e rëndë të ndonjë personi; apo përdorimin e ndonjë personi si mburojë njerëzore; apo
- ii. persekutimin, diskriminimin ose keqtrajtimin e ndonjë personi ose grupi të identifikueshëm në baza politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, fetare, gjinore apo në baza tjera të njohura si të palejueshme sipas të drejtës ndërkombëtare; apo
- iii. vjedhjen ose sekuestrimin apo konfiskimin e paligjshëm të tokës apo pronës dhe shkatërrimin e paligjshëm të pronës, duke përfshirë objektet fetare, kulturore, historike, kur kryhet së bashku me ndonjë nga veprimet e listuara më sipër në paragrafët (i) apo (ii); apo
- iv. çdo veprim apo mosveprim (përjashtim) që përbën një mbulesë ose një veprim apo mosveprim (përjashtim) që ka për qëllim të parandalojë ose pengojë administrimin e duhur të drejtësisë në lidhje me ndonjë prej akteve të përmendura në paragrafët (i) deri (iii);
- v. çdo përpjekje, konspiracion, shtytje, nxitje, urdhërim ose bindjen për të kryer një veprim ose veprime, të përmendura në paragrafët (i) deri në (iv);
- vi. çdo shkelje e ligjeve, standardeve ose instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme në Kosovë ose në territorin që përbën Kosovën;
- vii. çdo shkelje e së drejtës ndërkombëtare penale, së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe së drejtës ndërkombëtare zakonore, duke përfshirë krimin e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.

1.26. **Ushtarë në konfliktet e armatosura:** konsiderohen pjesëtarët e forcave të armatosura të shtetit dhe pjesëtarët e grupeve të armatosura tjera të organizuara, të njohura si të tilla dhe të cilat veprojnë nën komandën përgjegjëse, gjatë kryerjes së operacioneve ushtarake, që u nënshtrohen dispozitave të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare siç janë të përcaktuara me Protokollin Plotësues II dhe me katër Konventat e Gjenevës;

1.27. **Viktimë** - nënkupton çdo person që, individualisht ose së bashku me një ose më shumë persona, ka pësuar dëm në formën e dëmtimit fizik ose mendor, vuajtjes emocionale, humbjes ekonomike ose financiare ose dëmtimit substancial të të drejtave të tjera të njeriut si pasojë e një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut, dhe përfshinë anëtarë të ngushtë të familjes, të afërm ose vartës të viktimave, gjatë periudhës në shqyrtim të Komisionit.

## **KAPITULLI II – THEMELIMI, STATUSI, VLERAT DHE PARIMET E PUNËS SË KOMISIONIT**

### **Neni 4**

#### **Themelimi dhe Statusi i Komisionit**

1. Komisioni është institucion i pavarur, i themeluar me këtë akt normativ dhe ka subjektivitet juridik.
2. Komisioni është person juridik publik me të drejta, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë akt normativ, aktet e brendshme të Komisionit dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Institucioni themelues siguron kushte për punë dhe funksionim të Komisionit.

### **Neni 5**

#### **Selia dhe emblema e Komisionit**

1. Selia e Komisionit është në Prishtinë.
2. Komisioni, sipas nevojës, mund të themelojë degë, në pajtim me këtë akt normativ dhe aktin e saj të brendshëm, si dhe duke iu përgjigjur objektivave dhe natyrës së punës së Komisionit.
3. Komisioni vendos mbi identitetin e vet pamor që përfshin emblemën dhe vulën.

### **Neni 6**

#### **Përbërja e Komisionit**

1. Komisioni përbëhet nga nëntë (9) Komisionerë.
2. Komisioni kryesohet nga Kryekomisioneri dhe dy Zëvendës Kryekomisionerë. Së paku njëri nga zëvendësit duhet të jetë nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.
3. Përbërja e anëtarëve të Komisionit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës, dhe një minimum prej:
  - 3.1. tridhjetë për qind (30%) të Komisionerëve duhet të jenë të gjinisë së kundërt;
  - 3.2. dy (2) Komisionerë emërohen nga radhët e komuniteteve joshqiptare;
  - 3.3. dy (2) Komisionerë duhet të kenë kualifikime profesionale në fushën e drejtësisë transicionale dhe/apo mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

### **Neni 7**

#### **Kriteret për zgjedhjen e komisionerëve**

1. Kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e komisionarëve janë:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 1.4. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- 1.5. të jetë person me njohuri të larta në fushën e të drejtave të njeriut si dhe në promovimin e të drejtave të njeriut ose të shërbimit në jetën publike;
- 1.6. të jetë person me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional, moral, tolerant dhe konstruktiv, i paanshëm dhe kompetent për t'u marrë me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me këtë akt normativ;
- 1.7. të jetë person që nuk ka pasur dhe nuk ka ndonjë rol partiak-politik, përtej anëtarësisë së thjeshtë, në çfarëdo kohe; si dhe
- 1.8. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij akti normativ.

2. Anëtarët e Komisionit përzgjidhen me një proces transparent sipas standardeve të përcaktuara me këtë akt normativ dhe në pajtim me standardet më të larta të etikës profesionale, si dhe duke siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës.

## **Neni 8**

### **Përbërja dhe përzgjedhja e Panelit përzgjedhës**

1. Udhëheqësi i Institucionit themelues emëron Panelin përzgjedhës i cili është përgjegjës për përzgjedhjen e komisionerëve.
2. Paneli përzgjedhës përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, si në vijim:
  - 2.1. Avokati i Popullit;
  - 2.2. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor;
  - 2.3. Kryetari i Akademisë së Shkencave;
  - 2.4. Tre anëtarë nga radhët e shoqërisë civile si dhe
  - 2.5. Tre anëtarë nga radhët e shoqatave të dala nga lufta që përfaqësojnë viktimat.
3. Anëtarët e Panelit Përzgjedhës, nga radhët e shoqërisë civile dhe shoqatave të dala nga lufta, zgjedhën përmes një procesi konsultativ dhe transparent.
4. Administrata e Institucionit themelues/Sekretaria e Ekipit i siguron udhëheqësit të Institucionit themelues listën e kandidatëve të Panelit përzgjedhës.
5. Udhëheqësi i institucionit themelues nxjerr vendim për emërimin e Panelit përzgjedhës dhe emëron njërin nga anëtarët e Panelit përzgjedhës, kryesues/e të tij.

6. Administrata e Institucionit themelues/Sekretaria e Ekipit shpall zgjedhjen e Komisionit përzgjedhës dhe i siguron kushtet për punën e tij.
7. Pas procesit të shpalljes së zgjedhjes së Panelit Përzgjedhës, Kryesuesi e cakton mbajtjen e takimit themelues.

## **Neni 9**

### **Zgjedhja e kandidatëve për Komision**

1. Komisionerët zgjedhën përmes një procesi konsultativ, konkurrues dhe transparent.
2. Procedurat e kandidimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit i zbaton Paneli përzgjedhës.
3. Kandidaturat e pranuar shqyrtohen nga Paneli Përzgjedhës.
4. Administrata e Institucionit themelues/Sekretaria e Ekipit, pas miratimit të konkursit nga ana e Panelit Përzgjedhës, ku bëhet përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të Komisionit, në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë akt normativ, bën shpalljen publike të konkursit dhe fton që të bëhet aplikimi nga persona të kualifikuar në bazë të këtij akti normativ për emërim si komisionerët.
5. Konkursi duhet të jetë i hapur në afat prej tridhjetë (30) ditësh dhe të shpallet në së paku në dy gazeta, në televizionin publik dhe në gjuhët zyrtare.
6. Udhëheqësi i Institucionit themelues siguron që të bëhet verifikimi i kandidatëve nga institucionet përkatëse.
7. Paneli përzgjedhës mund të kërkojë informata për kandidatin nga organet shtetërore dhe institucionet publike, ndërsa ato janë të obliguara që, në kërkesën e Panelit përzgjedhës për qasje në informata, të përgjigjen me urgjencë.
8. Paneli përzgjedhës fton në intervistë vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë akt normativ dhe të cilët e kalojnë procesin e verifikimit.
9. Në afat prej tetë (8) ditësh, nga dita e arritjes së verifikimeve, Paneli përzgjedhës shpall në ueb faqen e institucionit themelues dhe në së paku në dy gazeta, në televizionin publik dhe në gjuhët zyrtare emrat e të gjithë kandidatëve, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen. Në të njëjtën kohë, Paneli përzgjedhës publikon aplikacionet dhe CV-të e kandidatëve (duke larguar detajet e kontaktit dhe informata të tjera të ndjeshme) të të gjithë kandidatëve, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen në ueb faqen e institucionit themelues dhe fton publikun që së paku brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të japë komente për kandidatët.
10. Intervistimi i kandidatëve bëhet publikisht dhe mediat elektronike do të ftohen për të transmetuar dhe/ose për të shfaqur intervistat drejtpërdrejt.
11. Komisioni përzgjedhës vendimet i merr me konsensus, ndërsa në rastet kur konsensusi nuk mund të arrihet, vendoset me shumicë prej pesë (5) anëtarëve. Rangimi i kandidatëve bëhet sipas poentimit.



12. Paneli përzgjedhës pas intervistimit i rekomandon udhëheqësit të Institucionit themelues jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) persona të kualifikuar të përshtatshëm për t'u emëruar si komisionerë, në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale, integritetit dhe përkushtimit të tyre për fushëveprimin e Komisionit, dhe për ta bërë këtë, Paneli përzgjedhës do t'i rangojë dhe të japë komente në lidhje me secilin nga pesëmbëdhjetë finalistët.

13. Udhëheqësi i Institucionit themelues mund të refuzojë vetëm personat në listën e ngushtë të ofruar nga Paneli përzgjedhës, kur personat e tillë, në mënyrë të dukshme, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë akt normativ. Në raste të tilla do bëhet arsyetimi me shkrim për shkaqet e refuzimit.

14. Kur Udhëheqësi i Institucionit themelues hedh poshtë shumicën prej kandidatëve të listës së ngushtë, ai do ta këshillojë Panelin përzgjedhës dhe do të bëjë thirrje për paraqitjen e emrave shtesë të kandidatëve apo përsëritjen e konkursit për plotësimin e anëtarëve të Komisionit.

15. Udhëheqësi i Institucionit themelues, brenda më së largu prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e propozimeve finale nga Paneli përzgjedhës, zgjedh nëntë persona për emërim si Komisionerë dhe nga radhët e këtyre nëntë anëtarëve zgjedh Kryekomisionerin dhe dy zëvendës Kryekomisionerët.

16. Udhëheqësi i Institucionit themelues mund të emërojë edhe persona për Listën rezervë të komisionerëve, të cilët do të zëvendësojnë komisionerët në rastet e ndërprerjes së mandatit të Komisionerit, siç përcaktohet në këtë akt normativ.

## **Neni 10**

### **Mbledhja konstituive**

1. Kryekomisioneri e thërret mbledhjen konstituive në selinë e Komisionit, më së largu në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e emërimit të anëtarëve të Komisionit.

2. Komisioni konsiderohet se është themeluar nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Komisionit.

## **Neni 11**

### **Betimi**

1. Komisionerët marrin detyrën pasi të kenë dhënë betimin para udhëheqësit të Institucionit themelues.

2. Teksti i betimit është si në vijim:

*“Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës si anëtar i Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin do t'i qëndroj besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe funksionin e anëtarit/anëtares të Komisionit do ta kryej në përputhje me Aktin Normativ, me nder, me përkushtim, me përgjegjësi, me paanshmëri dhe i pavarur, duke u përpjekur që të arsyetoj besimin e dhënë dhe të kontribuoj në realizimin e qëllimeve të Komisionit duke i respektuar rregullat e etikës profesionale.*

*Betohe më!”*

3. Komisionerët nënshkruajnë tekstin e betimit si dhe nënshkruajnë Deklaratën nën Betim, sipas Rregullores së Punës së Komisionit.
4. Betimi i Komisionerëve bëhet me një ceremoni publike para udhëheqësit të Institucionit themelues, nëse udhëheqësi i Institucionit themelues nuk vendos ndryshe.

## **Neni 12**

### **Vlerat dhe parimet e punës në Komision**

1. Komisionerët si dhe personeli i Sekretariatit në punën e tyre udhëhiqen nga këto vlera dhe parime:
  - 1.1. respektimi i dinjitetit njerëzor;
  - 1.2. barazia dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, duke përfshirë respektimin e barazisë gjinore dhe të drejtat e komuniteteve;
  - 1.3. pavarësia dhe paanshmëria kundrejt interesave që nuk përfaqësojnë shoqërinë kosovare, si tërësi;
  - 1.4. përkushtimi për të vërtetën dhe hulumtim metodologjik dhe paanshmëri procedurale;
  - 1.5. llogaridhënie, përgjegjësia, përgjegjshmëria, qasja dhe të qenit të hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe palët e interesuara;
  - 1.6. integriteti, vendosmëria dhe përkushtimi në standardet më të larta profesionale dhe etike.
2. Komisionerët si dhe personeli i Sekretariatit, gjatë punës së tyre, duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektiv dhe të paanshëm si dhe kërkohet që të tregojnë respekt për njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive.

## **Neni 13**

### **Trajtimi i viktimave dhe i të mbijetuarve**

1. Trajtimi i viktimave dhe i të mbijetuarve, nga komisionerët dhe personeli i Sekretariatit, duhet të bëhet në përputhje me parimet e mëposhtme:
  - 1.1. Viktimat dhe të mbijetuarit duhet të trajtohen me respekt dhe dinjitet dhe nuk duhet të diskriminohen në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër;
  - 1.2. procedurat për trajtimin e viktimave dhe të të mbijetuarve duhet të jenë të shpejta, të drejta, të çashtme dhe që atyre të mos u krijohet apo faturojnë asnjë kosto financiare;
  - 1.3. viktimat dhe të mbijetuarit duhet të informohen për të drejtat e tyre përmes mediave apo formave tjera të përshtatshme, duke përfshirë informata rreth:

1.3.1. rolit të Komisionit dhe fushëveprimit të aktiviteteve të tij;

1.3.2. të drejtës së viktimave dhe të të mbijetuarve për t'i paraqitur dhe shqyrtuar pikëpamjet dhe parashtrimet e tyre në fazat e përshtatshme të veprimeve të Komisionit;

1.4. duhet të merren masat e duhura për t'i zvogëluar shqetësimet e viktimave dhe të të mbijetuarve, veçanërisht viktimave të abuzimit seksual dhe anëtarëve të familjeve të tyre dhe dëshmitarëve, për të:

- 1.4.1. mbrojtur privatësinë e tyre,
- 1.4.2. garantuar sigurinë e tyre, dhe
- 1.4.3. mbrojtur nga kërcënimet.

1.5. duhet të merren masa të përshtatshme për t'u lejuar viktimave dhe të mbijetuarve të komunikojnë në gjuhën e zgjedhur nga ata.

## **Neni 14**

### **Fokusimi gjinor**

1. Komisioni do të sigurojë që shkeljet me bazë gjinore do të adresohen në mënyrë adekuate, në të gjitha fazat, për të gjitha masat, veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me punën e Komisionit.
2. Secili trup i Komisionit do të marrë në konsideratë dhe të adresojë ndikimet gjinore të aktiviteteve të tyre.
3. Komisionerët dhe personeli i Sekretariatit, gjatë periudhës përgatitore dhe më pastaj edhe në mënyrë periodike, duhet të kenë trajnime për ndjeshmërinë gjinore.

## **Neni 15**

### **Pavarësia e Komisionit**

1. Komisioni funksionon në mënyrë të pavarur.
2. Komisioni gëzon autonomi të plotë dhe të papenguar për të marrë vendime në lidhje me veprimtarinë dhe financat e tij, me kusht që vendimet e tilla të mos jenë në kundërshtim me këtë akt normativ dhe legjislacionin përkatës në fuqi, duke iu përmbajtur parimit të efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomizimit.
3. Komisionarët emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes tjetër, përpos interesit të Komisionit.
4. Asnjë person, institucion, entitet apo organ, duke përfshirë edhe subjektet qeveritare, nuk mund të ndërhyjë në funksionimin e Komisionit.
5. Komisionarët si dhe personeli i Sekretariatit, nuk pranojnë asnjë udhëzim në lidhje me aktivitetet e Komisionit nga asnjë person apo subjekt jashtë Komisionit, dhe duhet t'i ushtrojnë kompetencat e tyre pa frikë, favore apo paragjykime.
6. Organet shtetërore duhet të ndihmojnë dhe mbrojnë Komisionin për të siguruar pavarësinë, paanshmërinë dhe dinjitetin e tij.

## **Neni 16**

### **Periudha e veprimit të Komisionit**

1. Periudha e veprimit të Komisionit është tre (3) vjet.
2. Periudha e veprimit të Komisionit nuk përfshin periudhën përgatitore, e cila fillon nga mbledhja konstituive dhe vazhdon, më së largu gjashtë (6) muaj nga mbajtja e mbledhjes konstituive.
3. Pas përfundimit të përgatitjeve, Komisioni e bën publike datën e fillimit dhe mbarimit të punës së tij.
4. Veprimtaria dhe puna e Komisionit, me kërkesë të Komisionit, mund të zgjatet më së shumti deri në gjashtë (6) muaj, nëse Institucioni themelues e vlerëson si të nevojshme për arritjen e qëllimit të përcaktuar me këtë akt normativ.

## **Neni 17**

### **Periudha në shqyrtim e Komisionit**

1. Periudha në shqyrtim e Komisionit përfshin intervalin kohor prej: 23 mars 1989 deri më 17 shkurt 2008.
2. Periudha në shqyrtim, sipas paragrafit një (1) të këtij neni, nuk e kufizon Komisionin, për të hulumtuar rrethanat politike dhe shoqërore, që kanë zanafillën në periudha tjera kohore, të cilat kanë ndikuar në armiqësi, shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera masive të të drejtave të njeriut, shkeljen e të drejtës humanitare ndërkombëtare, gjatë periudhës në shqyrtim të Komisionit.

## **Neni 18**

### **Mbështetja në punën e Komisionit**

1. Mbështetjen në punën e Komisionit e siguron Sekretariati.
2. Sekretariati ka detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë akt normativ, aktet e brendshme të Komisionit dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **KAPITULLI III – QËLLIMET, VEPRIMTARIA, DETYRAT DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT**

## **Neni 19**

### **Qëllimet e Komisionit**

1. Komisioni ka për qëllim që të:
  - 1.1. krijojë një regjistër të saktë të shkeljeve të masive të të drejtave të njeriut, shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare, të shkaktuara ndaj qytetarëve të Kosovës, në territorin e Kosovës dhe ish RSFJ-së, gjatë periudhës në shqyrtim të Komisionit, duke përfshirë shkaqet,

precedentët, rrethanat, kontekstet, natyrën dhe shkallën e shkeljeve të tilla, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në:

1.1.1. zbulimin e së vërtetës prapa shkeljeve të tilla, hedhjes poshtë të gënjeshtreve dhe demaskimit të thashethemeve;

1.1.2. ofrimin e mundësive për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut që të ofrojnë pikëpamjet e tyre;

1.1.3. ofrimin e mundësive për të shprehur pikëpamjet dhe motivet e tyre për shkeljet e tilla për personat përgjegjës për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

1.2. ndihmojë në rikthimin e dinjitetit të viktimave dhe të të mbijetuarve dhe në ndërtimin e kulturës së solidaritetit me viktimat dhe të mbijetuarit, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në:

1.2.1. krijimin e një ambienti të sigurt për viktimat që të dalin hapur për të folur për përvojat e tyre;

1.2.2. pranimin e dëmeve dhe vuajtjeve të përrjetuara nga viktimat dhe të mbijetuarit;

1.2.3. duke i kushtuar vëmendjen e posaçme të shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë gjinore dhe abuzimit të fëmijëve përmes hulumtimit të shkeljeve të tilla dhe shkaqeve të tyre;

1.3. Të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, duke:

1.3.1. Promovuar paqen, shtet ndërtimin, respektin për sundimin e ligjit, si dhe duke ndihmuar në krijimin e kushteve për paqe të qëndrueshme dhe pajtim shoqëror në Kosovë;

1.3.2. rimëkëmbur besimin midis individëve dhe shoqërisë kosovare në tërësi;

1.3.3. dhënë rekomandime që adresojnë shkaqet e konfliktit dhe masat për të dëmshpërblyer dhe adresuar vuajtjet dhe padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave dhe të mbijetuarve;

1.3.4. edukuar publikun dhe ngritur vetëdijen për gjetjet e Komisionit.

1.4. kontribuojë në realizimin e të drejtave të njeriut dhe drejtave të tjera të viktimave dhe të të mbijetuarve; dhe

1.5. Të kontribuojë në ndriçimin e fatit të të zhdukurve.

## **Neni 20**

### **Veprimtaria e Komisionit**

1. Veprimtaria e Komisionit është veprimtari e interesit të veçantë për shoqërinë e Kosovës.

2. Interesi i veçantë publik i Komisionit shprehet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, për dokumentimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të masive të të drejtave të njeriut në:

- 2.1. territorin e Kosovës dhe
- 2.2. për qytetarët e Kosovës në territorin e ish-RSFJ-së.

## **Neni 21**

### **Detyrat e Komisionit**

1. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është të bëjë hulumtimin dhe dokumentimin e humbjeve njerëzore, personave të zhdukur, shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe dëmeve ekonomike dhe kategoritë e këtyre dëmeve, brenda periudhës në shqyrtim të Komisionit.

2. Detyra shtesë të Komisionit, të cilat i nënshtrohen objektivit parësor të tij, të përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij Neni, janë për të:

- 2.1. hulumtuar rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, në mënyrë vendimtare, kanë ndikuar në armiqësi, shpërthimin e luftërave ose formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjen e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut;
- 2.2. hulumtuar rolin e akterëve kyç në konflikt;
- 2.3. marrë deklaratat, të grumbullojë të dhëna për rastet e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve tjera masive të të drejtave të njeriut, të ofrojë përshkrim të detajuar për to, dhe të pasqyrojë shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;
- 2.4. hulumtuar incidente dhe praktika të përzgjedhura që përcaktojnë natyrën dhe karakterin e shkeljeve;
- 2.5. filluar hulumtime të posaçme për dhunën në baza gjinore dhe abuzimin e fëmijëve dhe të rinjve;
- 2.6. grumbulluar të dhëna mbi vendet e burgosjes të ndërlidhura me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur, të personave të cilët janë burgosur në mënyrë joligjore, u janë nënshtuar torturave dhe sjelljeve jonjerëzore, dhe të hartojë një regjistrim gjithëpërfshirës, me mbrojtjen e identitetit të tyre në rastet kur është e nevojshme;
- 2.7. avancuar pajtimin dhe rimëkëmbjen shoqërore ndërmjet individëve dhe komuniteteve;
- 2.8. lehtësuar parashtrimet në çfarëdo formati nga qytetarët, palët e interesit dhe ekspertët për çështjet që lidhen me mandatin e Komisionit dhe në veçanti për masat për të garantuar mos përsëritje;

2.9. rekomanduar masa, politika dhe legjislacion që adresojnë shkaqet e konfliktit, kontribuojnë në transformimin social dhe shërbejnë në parandalimin e përsëritjes së shkeljeve masive të të drejtave të njeriut;

2.10. paraqitur institucionit themelues, deri me 31 mars të vitit vijues, raportin vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me aktivitetet e ndërmarra, aktivitetet financiare, si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik në të njëjtën kohë kur i dorëzohet institucionit themelues;

2.11. hartuar, publikuar dhe prezantuar raportin përfundimtar, përfshirë mekanizmat se si gjetjet nga ky raport të depërtojnë deri te një numër sa më i madh i njerëzve në territorin e Kosovës dhe të gjejë mundësi që ky raport të depërtojë edhe në shtetet që kanë dalë nga ish-RSFJ-ja dhe në vendet tjera.

## **Neni 22**

### **Kompetencat e Komisionit**

1. Pa paragjykuar kompetencat dhe funksionet e përcaktuara diku tjetër në këtë Akt normativ, Komisioni ka kompetenca për të:

1.1. krijuar apo udhëhequr nën komisione për të ushtruar, kryer ose zbatuar ndonjë nga kompetencat, detyrat dhe funksionet që i janë caktuar nga Komisioni;

1.2. krijuar njësi të veçanta dhe të miratojë mekanizma dhe procedura specifike për të adresuar çështje specifike;

1.3. kryer ndonjë hulumtim, mbajtur ndonjë seancë apo referuar ndonjë çështje specifike, që mund ta konsiderojë të nevojshme;

1.4. shqyrtuar vendimet e çfarëdo nën komisioni, njësie ose organi të Komisionit, në lidhje me:

1.4.1. ushtrimin e kompetencave të veta,

1.4.2. përmbushjen e funksioneve dhe kryerjen e detyrave, dhe

1.4.3. procedurat e punës që duhet të ndiqen.

1.5. udhëhequr dorëzimin dhe pranimin e raporteve dhe raporteve të përkohshme nga cilindo komision, nën komision apo njësi;

1.6. deleguar në shërbim të tij, nga ndonjë departament i shtetit, me kërkesë të tij;

1.7. konsultuar dhe bashkëpunuar me Ministrinë përkatëse, në mënyrë që përmes kanaleve diplomatike, të marrë leje nga autoriteti përkatës të ndonjë shteti të huaj, për të marrë prova ose për të mbledhur informacion në ose nga ai vend;

1.8. lidhur marrëveshje bashkëpunimi me cilindo person, përfshirë cilindo departament të shtetit, në lidhje me të cilin Komisioni do të autorizohet të përdorë cilindo nga objektet, pajisjet ose personelin që i përkasin ose që janë nën kontroll ose në punësimin e ndonjë personi ose departamenti të tillë;

1.9. vlerësuar dhe mbajtur shënime për gjetjet dhe rekomandimet e hulumtimeve të mëparshme për cilëndo lëndë që është në mandatin e Komisionit dhe kur Komisioni vlerëson që gjetjet dhe rekomandimet e tilla janë të sakta dhe të përshtatshme, të miratojë gjetjet dhe rekomandimet e tilla;

1.10. mbajtur takime kudo brenda apo jashtë zyrës qendrore.

## **Neni 23**

### **Detyrat e Komisionerëve**

1. Komisionerët:

1.1. janë të obliguar për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi në mënyrë të paanshme, në përputhje me mandatin e Komisionit;

1.2. kanë për detyrë të marrin pjesë në punën dhe procesin e vendimmarrjes së Komisionit, si dhe të kryejnë punët e caktuara në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi;

1.3. duhet të punojnë me orar të plotë dhe nuk mund të ushtrojnë ndonjë detyrë tjetër publike apo profesionale apo ndonjë punë tjetër me pagesë kur ai/ajo është komisioner/e dhe nuk mund të kryejnë ndonjë punë të papaguar që do të ishte në kundërshtim me pozicionin e tij/saj si komisioner/e;

1.4. mund të merren me mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë, veprimtari shkencore, kulturore, akademike dhe veprimtari tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me funksionet e tyre në Komision dhe me legjislacionin në fuqi;

1.5. kanë për detyrë të ruajnë autoritetin dhe imazhin e Komisionit;

1.6. nuk kanë të drejtë që gjatë mandatit të tyre në komision të jenë anëtar të partisë politike apo të marrin pjesë në aktivitete politike të partive;

1.7. duhet që të vendosin interesat e Republikës së Kosovës dhe Komisionit mbi interesat e tyre apo interesat e ndonjë grupi.

## **Neni 24**

### **Kryekomisioneri**

1. Kryekomisioneri ka këto kompetenca:

1.1. Udhëheq, përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarinë e Komisionit;

1.2. Organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme të Komisionit;

1.3. Thërret dhe kryeson takimet e Komisionit;



1.4. Jep autorizime për kryerjen e detyrave, cakton trupa punuese, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit, dhe nënshkruan vendimet dhe aktet tjera të Komisionit, në pajtim me vendimet dhe politikat e Komisionit;

1.5. Kryen dhe ndërmerr veprime në të mirë të punës së Komisionit;

1.6. Përfaqëson Komisionin në kontakt me publikun, brenda dhe jashtë vendit, apo autorizon njërin nga Zëvendëskryekomisionerët apo anëtarët e Komisionit për këtë përfaqësim;

1.7. Në koordinim me anëtarët e Komisionit përgatit planin e punës dhe projektbuxhetin, i cili i nënshtrohet aprovimit nga Komisioni;

1.8. Në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit, përcaktojnë punët dhe detyrat për anëtarët e Komisionit;

1.9. I mbanë të informuar anëtarët e Komisionit për punën dhe aktivitetet e Komisionit dhe çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë që nëpërmjet Kryekomisionerit të kërkojë çdo informacion për veprimtarinë e Komisionit;

1.10. Së bashku me Komisionin, siguron zbatimin e këtij akti normativ dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

1.11. Kryen detyra të tjera të cilat ia beson Komisioni.

2. Kryekomisioneri punon në mënyrë konsensuale dhe bashkëpunuese me anëtarët e Komisionit.

3. Çdo vendim i marrë nga Kryekomisioneri, mes mbledhjeve të Komisionit, i nënshtrohet miratimit nga Komisioni dhe mund të anulohet.

## **Neni 25**

### **Zëvendëskryekomisionerët**

1. Zëvendëskryekomisioneri e zëvendëson Kryekomisionerin në mungesë të tij dhe i ndihmon në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij.

2. Zëvendëskryekomisioneri kryen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Komisionit.

## **Neni 26**

### **Ndërprerja e mandatit të Komisionerit**

1. Komisionerit i pushon mandati me kalimin e mandatit të Komisionit, si dhe në rastet e:

1.1. Dhënies së dorëheqjes në formë të shkruar;

1.2. Shqiptimit të dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

1.3. Shkarkimit; dhe

#### 1.4. Vdekjes.

2. Në rastet e parapara në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.4 të këtij neni, Komisioni i dërgon propozimin udhëheqësit të institucionit themelues për lirim nga detyra. Udhëheqësi i Institucionit themelues brenda shtatë (7) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr vendim për lirin nga detyra të komisionerit.

3. Udhëheqësi i Institucionit themelues mund të shkarkojë Komisionerin për shkak të arsyeve në vijim:

3.1. për shkelje të dispozitave të këtij akti normativ;

3.2. kur kryen veprimtari, që krijon konflikt të interesit dhe, me gjithë paralajmërimin nga organi kompetent, nuk e eliminon konfliktin e interesit sipas ligjit përkatës;

3.3. në rastet e kryerjes së detyrave në papajtueshmëri apo sjelljes së keqe apo të pahijshme me funksionin e tij;

3.4. paaftësisë apo pamundësisë së vazhdueshme të kryerjes së punës zyrtare, për shkak të gjendjes së vështirë mendore dhe fizike;

3.5. mungon pa arsye në punë mbi pesë (5) ditë, për arsyet që nuk parashihen me ligj;

3.6. për shkak që nuk ka bërë të ditur ndonjë çështje që do të kishte ndikuar një vendim për të mos e emëruar atë;

3.7. është i njëanshëm, i paaftë ose jo i përshtatshëm për të mbajtur detyrën, me kusht që një mendim i tillë duhet të jetë i bazuar në fakte të arsyeshme.

4. Komisioni, propozimin për shkarkim të komisionerit/es, së bashku me të gjitha dëshmitë e mbledhura, ua dërgon komisionerëve dhe institucionit themelues. Udhëheqësi i Institucionit themelues, me këtë rast, do të:

4.1. caktojë një panel hetimor, i cili përbëhet nga një kryesues dhe dy anëtarë të tjerë. Kryesuesi do të jetë një gjyqtar në pension, një prokuror në pension dhe një ekspert i së drejtës;

4.2. paneli hetimor, brenda 30 ditëve nga emërimi i tij, do të hetojë çështjen dhe, duke zbatuar drejtësinë procedurale, do të vendosë nëse komisioneri duhet të largohet nga detyra apo jo dhe t'i komunikojë vendimin Udhëheqësit të institucionit themelues dhe Komisionit;

4.3. Kur largimi i një komisioneri i është referuar institucionit themelues për sa i përket këtij neni, udhëheqësi i institucionit themelues mundet që, me iniciativën e tij/saj ose me kërkesë të Komisionit, të pezullojë komisionerin nga Komisioni në pritje të vendimit të panelit hetimor, me kusht që pezullimi në çdo kohë mund të revokohet nga udhëheqësi i institucionit themelues, për një shkak të mirë të treguar, në pritje të vendimit të grupit hetimor.

5. Udhëheqësi i institucionit themelues mund të plotësojë çdo boshllëk duke emëruar një person për pjesën e mandatit të paraardhësit të tij/saj apo mund ta lërë vendin bosh si rezultat i një dorëheqjeje, largimi nga detyra apo vdekjeje, me kusht që numri minimal i komisionarëve duhet të jetë gjithnjë një numër tek dhe të mos bjerë nën shtatë.

6. Kur Udhëheqësi i Institucionit themelues vendos të plotësojë një vend të lirë, ai do të zgjedhë anëtarin e ri të Komisionit nga lista rezervë dhe nëse asnjë prej këtyre personave nuk është në dispozicion, atëherë zhvillohet procedura e përzgjedhjes siç përcaktohet me këtë Akt normativ.

## **KAPITULLI IV– PROCESI I PUNËS SË KOMISIONIT**

### **Neni 27**

#### **Periudha përgatitore**

1. Periudha përgatitore përfshin, por nuk kufizohen në:
  - 1.1. Miratimin e planit të punës;
  - 1.2. Miratimin e Rregullores së Punës së Komisionit dhe akteve tjera të nevojshme;
  - 1.3. Përpilimin e planit për punësim dhe angazhim të personelit të Sekretariatit;
  - 1.4. Trajnimin e personelit të Sekretariatit;
  - 1.5. Shqyrtimin e planeve të veçanta për seanca të mundshme publike dëgjimore;
  - 1.6. Përgatitjen e buxhetit dhe sigurimin e fondeve nga burimet vendore dhe ndërkombëtare;
  - 1.7. Disenjimin dhe instalimin e një baze të efektshme të dhënash për ruajtje, sistemim dhe nxjerrjen e informacioneve lidhur me çështjet që mund t'i raportohen komisionit;
  - 1.8. Përpunimin e një fushate publike;
  - 1.9. Grumbullimin e dokumentacionit ekzistues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, si dhe nga burimet e tjera.

### **Neni 28**

#### **Rregullat e Mirësjelljes**

1. Komisionerët dhe personeli i Sekretariatit duhet:
  - 1.1. të jenë të paanshëm dhe të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe pa paragjykim në kryerjen e funksioneve të tyre;
  - 1.2. të veprojnë me integritet dhe të mos sillen në kundërshtim me postin e tyre apo ta ekspozojnë vetën para ndonjë situatë që përfshin rrezikun e një konflikti midis përgjegjësisë së tyre zyrtare dhe interesave private apo interesave të tjera;
  - 1.3. të jenë të zellshëm, efektivë dhe efikas në kryerjen e funksioneve të tyre;

1.4. të mos shpërndajnë asnjë informacion të marrë gjatë punës dhe fushëveprimit të punës së tyre me Komisionin, te ndonjë person tjetër përveçse gjatë kryerjes së funksioneve të tyre me Komisionin;

1.5. të mos e përdorin pozicionin e tyre ose çfarëdo informacioni që u është besuar atyre, për t'u pasuruar ose për të përfituar në mënyrë të padrejtë nga ndonjë person tjetër;

1.6. të respektojnë faktin që të dhënat dhe materialet e krijuara dhe të mbledhura nga Komisioni i përkasin Komisionit, janë pjesë e trashëgimisë kombëtare të Kosovës dhe i përkasin popullit të Kosovës dhe nuk mund të largohen nga Komisioni përveç nëse heqja e tillë bëhet për ndonjë qëllim të autorizuar në bazë të këtij Akti.

2. Deri në atë masë sa anëtarët e stafit emërohen nga trupa apo entitete tjera shtetërore në Komision, ky staf do të jetë llogaridhënës dhe do t'i raportojë vetëm Komisionit dhe askujt tjetër.

3. Nëse në çfarëdo faze gjatë zhvillimit të procedurës në ndonjë mbledhje të Komisionit, nën komisionit ose organit të Komisionit, vërtetohet se një komisioner ose personel i Sekretariatit, mund të shkaktojë një konflikt të interesit në kryerjen e funksioneve të tij ose të saj, personi do të njoftojë menjëherë dhe plotësisht natyrën e interesit të tij/saj, në mënyrë që t'iu mundësojë komisionerëve të vendosin nëse ai ose ajo duhet të përjashtohet nga pjesëmarrja në takim për shkak të konfliktit të interesit, dhe në këtë rast:

3.1. Një zbulim i tillë dhe vendimi i marrë nga komisionerët e mbetur, dhe, ose personeli i Sekretariatit, do të regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes;

3.2. Nëse një komisioner apo personel i Sekretariatit nuk njofton ndonjë konflikt interesi dhe është i pranishëm në një mbledhje të Komisionit, nënkomisionit ose një organi tjetër të Komisionit ose në ndonjë mënyrë merr pjesë në takim, takimi i tillë në lidhje me çështjen përkatëse, sapo të kuptohet për atë moszbulim, do të rishikohet dhe të ndryshohet ose të anulohet nga Komisioni, nën komisioni ose organi, pa pjesëmarrjen e personit në fjalë.

4. Komisionerët dhe personeli i Sekretariatit, nuk do të marrin pjesë në:

4.1. ndonjë procedurë të rastit ku ata kanë interes personal;

4.2. nëse janë konsultuar apo kanë ndonjë lidhje me palën;

4.3. nëse kanë qenë të përfshirë në ndonjë procedurë ligjore, që ka të bëjë me rastin, përveç procedurës së Sekretariatit dhe Komisionit, apo nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat mund të ndikojnë në paanësinë e tyre.

## **Neni 29**

### **Mbrojtja e të dhënave**

1. Komisioni siguron që çdo garanci e fshehtësisë nuk mund të shkelet nga asnjë organizëm i jashtëm.

2. Asnjë komisioner apo anëtar i personelit të Sekretariatit, me kontratë të plotë apo i kontraktuar, përpos për ushtrimin e kompetencave të tij apo të saj, kryerjes së detyrave apo kur i kërkohet nga gjykata, apo me ligj të caktuar, nuk do të bëjë publike asnjë informatë të marrë nga ai/ ajo, gjatë kohës sa janë të punësuar në Komision si dhe pas saj.

3. Të dhënat personale, jeta private dhe identiteti i personave si viktime, të mbijetuar dhe dëshmitar, mbrohet nga autoritetet përgjegjëse. Regjistrimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i të dhënave personale të këtyre personave bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, këtë akt normativ dhe legjislacionin përkatës në fuqi

4. Asnjë person, i cili nuk është i autorizuar nga Komisioni, nuk do të ketë qasje në asnjë informatë e cila është e klasifikuar sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

5. Komisioni siguron që kopjet identike të materialit përkatës të ruhen edhe në një vend tjetër.

6. Regjistrimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i informacionit të klasifikuar bëhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.

7. Çdo komisioner dhe çdo anëtar i personelit të Sekretariatit duhet të nënshkruajnë një Deklaratë nën Betim e cila konfirmon detyrimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe të dhënave që do të vijnë në njohurinë e tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

### **Neni 30**

#### **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. Kuorumi për punë të Komisionit ekziston kur janë prezent së paku pesë (5) anëtarë të Komisionit.

2. Komisioni bën përpjekje që të gjitha vendimet e Komisionit t'i nxjerrë njëzëri, por kur konsensusi është i pamundur të arrihet, së paku pesë (5) anëtarë duhet të pajtohen për marrjen e vendimit.

3. Rregullorja e Punës së Komisionit dhe Raporti përfundimtar i Komisionit miratohen me konsensus, por kur konsensusi është i pamundur të arrihet, miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Komisionit.

### **Neni 31**

#### **Përdorimi i gjuhëve**

1. Në punën e Komisionit, në përdorim të barabartë janë gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Palët në komunikim me Komisionin, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre.

3. Në dëgjimet publike, pjesëmarrësit mund të flasin në gjuhën e tyre dhe se përkthimi do të sigurohet kurdo që të jetë e nevojshme.

### **Neni 32**

## **Raportimi i Komisionit**

1. Komisioni për punën e vet i raporton udhëheqësit të Institucionit themelues, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme.
2. Komisioni respekton të gjitha obligimet raportuese ligjore dhe rregullative për menaxhimin efikas dhe efektiv të të gjitha të hyrave, shpenzimeve, mjeteve dhe detyrimeve të tyre.
3. Raportimi i rregullt vjetor, bëhet deri me 31 mars të vitit vijues.
4. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së udhëheqësit të Institucionit themelues apo sipas vlerësimeve të Komisionit.

## **KAPITULLI V – AKTIVITETET E KOMISIONIT**

### **Neni 33**

#### **Komunikimi i Komisionit me publikun**

1. Komisioni është i obliguar që:
  - 1.1. t'ia prezantojë dhe t'ia shpjegojë publikut punën dhe aktivitetet e tij;
  - 1.2. të përkujdeset që misioni dhe qëllimet e tij të kuptohen nga qytetarët;
  - 1.3. Ta mbajë publikun dhe mediat të informuara mbi zhvillimet dhe ngjarjet e planifikuara në mënyrë të rregullt dhe në kohë të duhur, si dhe
  - 1.4. T'u përgjigjet me kohë dhe në mënyrë të duhur kërkesave për informata.
2. Komisioni themelon një njësi përkatese për komunikim, për t'i mbështetur edhe aktivitetet në terren.

### **Neni 34**

#### **Mbështetja për viktimat dhe të mbijetuarit në procesin e punës së Komisionit**

1. Komisioni themelon një njësi për të:
  - 1.1. identifikuar dhe për të arritur deri tek viktimat dhe komuniteti i viktimave, dhe për t'u siguruar viktimave mundësi për të treguar, publikisht apo privatisht, versionin e tyre të shkeljeve apo dëmit të përjetuar dhe për të treguar nevojat e tyre;
  - 1.2. vlerësuar nevojat e viktimave dhe komunitetit të viktimave dhe për t'i rekomanduar Komisionit masa të përkohshme urgjente, masa të duhura për reparacion për viktimat individuale apo të kategorive të viktimave, dhe marrjen e masave tjera me qëllim të rehabilitimit dhe rikthimit të dinjitetit njerëzor dhe civil të viktimave individuale apo të kategorive të viktimave.
  - 1.3. siguruar, kur të jetë e nevojshme, mbështetje ligjore, psiko-sociale, mjekësore dhe logjistike për viktimat dhe të mbijetuar, gjatë periudhës kur janë të përfshirë në aktivitetet e Komisionit;

1.4. konsideruar dhe adresuar çështjet e referuara nga Komisioni, nënkomisioni, organ apo trup tjetër dhe nga ndonjë person, organizatë apo shoqatë tjetër;

1.5. të përgatisë dhe dorëzojë Komisionit raportin në lidhje me aktivitetet e saj.

2. Njësia e përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni, përkujdeset që edhe për komisionerët dhe anëtarët e Sekretariatit, të cilët, po ashtu, mund të vuajnë efekte të traumës, pasi t'i kenë dëgjuar rrëfimet për shumë muaj me radhë, që t'u ofrohen seanca dhe shërbime të mbështetjes psiko-sociale.

### **Neni 35**

#### **Mbështetja e viktimave të shkeljeve me bazë gjinore**

1. Komisioni cakton një njësi përkatëse që të:

1.1. rekomandojë protokolle për marrjen e deklaratave, mbledhje dhe analizë të të dhënave të veçanta mbi gjininë dhe seksin dhe për udhëheqjen e intervistave dhe seancave dëgjimore për të siguruar adresimin e plotë të çështjeve gjinore;

1.2. monitorojë praktikat gjinore brenda Komisionit dhe të këshillojë për praktikat dhe parimet më të mira.

2. Njësia, sipas paragrafit 1 të këtij neni, në koordinim me hulumtuesit e Komisionit, do të hulumtojë:

2.1. shkeljet e drejtave të njeriut me bazë gjinore, siç kanë ndodhur përgjatë periudhës që Komisioni e ka në shqyrtim;

2.2. përdorimin e dhunës me bazë gjinore, dhe

2.3. përdorimin e krimeve seksuale si armë e luftës për t'u shërbyer objektivave të entiteteve të tilla.

3. Njësia, sipas paragrafit 1 të këtij neni, së bashku me Njësinë për Mbështetje të Viktimave, do të:

3.1. gjejë dhe identifikojë viktimat e shkeljeve me bazë gjinore dhe do t'u mundësojë viktimave seanca të mbyllura, apo të hapura, të tregojnë versionin e tyre të abuzimit apo dëmit të pësuar dhe të tregojnë nevojat e tyre;

3.2. mbajë dëgjime specifike të hapura apo të mbyllura rreth:

3.2.1. natyrës gjinore dhe kontekstit të dhunës dhe marginalizimit;

3.2.2. shkaqet e dhunës së tillë dhe marginalizimit;

3.2.3. propozimit për të adresuar çështjet e potencuara.

4.3. të vlerësojë nevojat e viktimave të shkeljeve dhe marginalizimeve me bazë gjinore dhe të bëjë rekomandime për Komisionin, të cilat mund të përfshijnë masa paraprake urgjente,

si dhe masat e duhura të nevojshme për të adresuar shkeljet dhe marginalizimin, duke përfshirë edhe politikat që duhet të ndiqen ose masat që duhet të ndërmerren për të rikthyer dinjitetin e viktimave;

4.4. të marrë në konsideratë masat e referuara nga:

- 4.4.1. Komisioni apo nga ndonjë trup i themeluar nga Komisioni;
- 4.4.2. ndonjë trup tjetër i themeluar me legjislacionin në fuqi, dhe
- 4.4.3. ndonjë person, organizatë apo shoqatë.

## **Neni 36**

### **Marrja e deklaratave**

1. Komisioni merr deklaratat për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, dhe çfarëdo çështje tjetër relevante me mandatin e tij dhe sipas kompetencës së vet, nga viktimat, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesit e veprave.
2. Viktimat, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesit e veprave japin deklaratat në bazë vullnetare.
3. Komisioni siguron se marrja e dëshmive kryhet në mënyrë reprezentative në mbarë vendin.
4. Komisioni, sipas nevojës, siguron ndihmën psiko-sociale, para, gjatë dhe pas dhënies së deklaratës,.
5. Komisioni i merr deklaratat në çfarëdo vendi të përcaktuar, duke përfshirë por mos u kufizuar në:
  - 5.1. vendbanimin apo në vendqëndrimin e dhënësit të deklaratës;
  - 5.2. zyrat e Komisionit, qendra të komunitetit apo ndonjë lokal tjetër të përshtatshëm;
  - 5.3. misionet diplomatike të Republikës së Kosovës;
  - 5.4. territorin e shteteve të treta, nëse një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, dhe në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund të japin deklarata në misionet diplomatike të Republikës së Kosovës apo pas konsultimeve me ministrin përkatëse përmes kanaleve diplomatike, dhe kur është marrë leja nga autoriteti respektiv i vendit të huaj për të pranuar dëshmi apo mbledhur informata në apo nga ai vend.

## **Neni 37**

### **Grumbullimi i dokumentacioneve dhe burimeve tjera**

1. Komisioni grumbullon materiale burimore relevante të shkruara dhe elektronike, siç janë:
  - 1.1. burimet e huaja dhe vendore të shkruara dhe elektronike (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në dokumentacionin e Qeverisë, Kuvendit, Presidencës, Forcës së Sigurisë së Kosovës, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës, Agjencisë Kosovare të



Inteligjencës dhe të institucioneve tjera të sigurisë, komunave, ndërmarrjeve publike dhe private, organizatave joqeveritare;

1.2. aktgjykimet gjyqësore, transkriptet, shkresat gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë, gjykatave të Republikës së Kosovës dhe gjykatave tjera të cilat zhvillojnë procedura për krime lufte të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë në bazë të kompetencave;

1.3. lëndët arkivore;

1.4. burimet mediale, të shkruara dhe elektronike;

1.5. mendimet e shkruara të ekspertëve dhe përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave, të përgatitura me ftesë të Komisionit ose me vetiniciativë të autorëve.

2. Organet shtetërore, personat e tjerë juridikë dhe qytetarët, me kërkesë të Komisionit, i dorëzojnë në shqyrtim dokumentet dhe burimet tjera, të cilat mund të jenë të rëndësishme për realizimin e qëllimit të tij. Me rastin e dorëzimit të ftesës për dorëzimin e dokumentacionit, Komisioni duhet që sa më saktë të precizojë llojin e informatës, të cilën do të duhej ta përmbajë dokumenti i kërkuar.

3. Dispozitat e legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me qasjen në dokumente zyrtare dhe legjislacioni që ka të bëjë me klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë zbatohen edhe në punën e Komisionit.

4. Për nevoja të punës, për personat të cilët në çfarëdo forme mund të kenë qasje në informacionet e klasifikuara, bëhet verifikimi i sigurisë së këtyre personave në pajtim me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 38**

#### **Hulumtimet dhe vizitat në terren**

1. Komisioni, për të kryer funksionet e tij, viziton lokalitetet me interes për vërtetimin e fakteve mbi shkeljen e të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe shkeljet tjera masive të të drejtave të njeriut.

2. Komisioni mund të lidhë marrëveshje mirëkuptimi, me organet shtetërore kompetente, për vizitat e tij në lokacionet e lartpërmendura.

### **Neni 39**

#### **Dëgjimi publik i viktimave dhe personave tjerë**

1. Dhënia e deklaratave në dëgjimin publik është vullnetare.

2. Komisioni organizon dëgjime publike në të cilat viktimat dhe të mbijetuarit tregojnë vuajtjet e tyre dhe të të afërmeve të tyre.

3. Dëgjimet publike mund të përfshijnë edhe kryerësit e veprave të cilët kanë karakterin e shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare ose të shkeljeve tjera masive të të drejtave të njeriut, dëshmitarët si dhe personat që i kanë ndihmuar viktimat.

4. Komisioni mund të aplikojë masa për mbrojtjen e identitetit, si dhe masa të veçanta për mbrojtjen e integritetit psiko – fizik, si dhe masat e ndihmës psiko-sociale, para, gjatë dhe pas dëgjimeve publike.

5. Radio Televizioni i Kosovës (RTK), transmeton dëgjimet publike. Mënyra e transmetimeve bëhet sipas marrëveshjes mes Komisionit dhe RTK-së. Mediat elektronike komerciale kanë të drejtë të emitojnë dëgjimet publike, nën kushte të njëjta dhe sipas rregullave të cilat vlejnë dhe për RTK-në.

6. Dëgjimet publike mund të mbahen në lokalitete të ndryshme.

7. Dëgjimet publike transmetohen dhe ruhen edhe në faqen e internetit të Komisionit.

#### **Neni 40**

##### **Mbajtja e sesioneve tematike dhe dëgjimet tjera**

1. Komisioni mund të mbajë sesione tematike për punën e institucioneve shtetërore, organizatave politike, entiteteve kulturore dhe shkencore, bashkësive fetare, dhe mediave për rolin e tyre gjatë dhe pas luftës, që kanë të bëjnë me nxitjen apo kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut.

2. Seancat dëgjimore mund të mbahen gjithashtu për ngjarje, incidente dhe hulumtime specifike, si dhe për të nxjerrë në pah praktikrat dhe çështjet e ndryshme që lindën gjatë kohës së armiqësisë apo kohës së luftës.

3. Transmetimet e drejtpërdrejta të këtyre dëgjimeve mund të bëhen në të njëjtën bazë siç përcaktohet në Nenin 39 (5) të këtij Akti.

#### **Neni 41**

##### **Dëgjimet e hapura dhe të mbyllura**

1. Në bazë të dispozitave të këtij Akti, dëgjimet e Komisionit do të jenë publike.

2. Dëgjimet mund të jenë të mbyllura ose të kufizuara në rastet kur Komisioni është i bindur se:

2.1. është në interesat e drejtësisë dhe punës së Komisionit; apo

2.2. ekziston dyshimi se mbajtja e një seance të hapur mund të shkaktojë dëme për personin që dëshmon përpara Komisionit;

2.3. Ekziston një kërkesë formale nga palët që seanca të jetë e mbyllur ose me publik të kufizuar.

3. Komisioni mund, në çdo kohë, të rishikojë vendimin e tij në lidhje me pyetjen nëse seancat do të mbahen apo jo me dyer të mbyllura.

4. Kur Komisioni për çfarëdo arsye të përmendur nën nën-paragrafin (2.2), udhëzon që publiku ose ndonjë kategori e tij nuk do të jetë i pranishëm në ndonjë seancë apo pjesë të tij, Komisioni:

4.1. siguron që asnjë informacion në lidhje me seancat, ose ndonjë pjesë e tyre që mbahet me dyer të mbyllura, nuk bëhet publike në asnjë mënyrë;

4.2. siguron që asnjë person të mos bëjë publike ndonjë informacion që mund të zbulojë identitetin e ndonjë dëshmitari në proces;

4.3. jep udhëzime të tilla në lidhje me mbajtjen e shënimeve gjatë seancave, që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur identitetin e çdo dëshmitari, me kusht që Komisioni të autorizojë publikimin e aq shumë informacioneve sa konsideron se do të ishin të drejta.

5. Kriteret për personat që dëshmojnë në një seancë publike duhet të jenë objektive, të drejta, publike dhe të pasqyrojnë qëllimet e përcaktuara në këtë Akt.

6. Të gjithë personat që paraqiten në seancat publike njoftohen paraprakisht nga Komisioni me procedurat e seancës dëgjimore dhe të drejtat ose detyrimet përkatëse.

7. Komunikimet midis bashkëshortëve, ndërmjet avokatit dhe klientit, midis profesionistit mjekësor dhe pacientit, dhe midis klerit fetar dhe besimtarit, do të konsiderohen të privileguara dhe me imunitet nga zbulimi, me kusht që komunikimet e tilla të jenë të pranueshme në një seancë dëgjimore publike me pëlqimin e personit në fjalë, ose kur personi i interesuar vullnetarisht i zbulon përmbajtjen e komunikimit një pale të tretë, i cili më pas jep prova të këtij zbulimi.

8. Personat që dëshmojnë në seancat dëgjimore publike të Komisionit marrin shërbime të duhura mbështetëse mjekësore, psikologjike ose emocionale për t'i ndihmuar ata të dëshmojnë në mënyrë efektive. Komisioni duhet të përkujdeset për viktimat dhe të mbijetuarit, pas dëshmisë së tyre publike, për të siguruar që mirëqenia e tyre nuk ishte në rrezik si rezultat i dëshmisë.

## **Neni 42**

### **Kompetencat në lidhje me hulumtimet dhe dëgjimet**

1. Komisioni ka kompetencat e mëposhtme, në lidhje me sjelljen, hulumtimet dhe dëgjimet:

1.1. Mbledhjen e çdo informacioni që ai e konsideron të rëndësishëm, përfshirë dëshminë gojore, deklaratat, raportet, regjistrimet, dokumentet ose çdo informacion nga ndonjë burim, përfshirë autoritetet qeveritare, me çdo mjet ligjor që ai i gjykon të përshtatshme, me njoftim të arsyetuar me shkrim;

1.2. thërret çdo person, që ka në posedim ose ka kontroll mbi cilindo dokument, objekt ose gjësend tjetër, i cili, sipas mendimit të Komisionit, është i rëndësishëm për temën e hulumtimit ose dëgjimit për të hartuar apo prodhuar një dokument ose gjësend të tillë të Komisionit, dhe Komisioni mund të mbajë çdo dokument, objekt ose gjësend tjetër që prodhohet për një kohë të arsyeshme;

1.3. i bën thirrje çdo personi të paraqitet para Komisionit dhe të dëshmojë ose t'u përgjigjet pyetjeve në seanca të mbyllura apo të hapura të rëndësishme për çështjen e hulumtimit ose dëgjimit.

1.4. Njoftimi i nënshkruar nga një komisioner, siç përcaktohet në nën-paragrafin 1.1, përcakton kohën dhe vendin ku personi të cilit i drejtohet duhet të paraqitet, si dhe do të specifikojë arsyen pse kërkohet dokumenti, objekti ose gjësendi ose pse duhet të jepen provat dhe do të specifikojnë pasojat e jo-pajtueshmërisë;

2. Komisioni do të rimbursojë shpenzimet e arsyeshme të personave të kërkuar për t'u paraqitur para Komisionit ose për të hartuar apo prodhuar një dokument, objekt ose gjësend tjetër përpara Komisionit;

3. Nëse Komisioni konsideron se hartimi apo prodhimi i ndonjë dokumenti, objekti apo gjësendi tjetër, në posedim ose nën kontrollin e Shtetit ose ndonjë organi të shtetit, mund të ndikojë negativisht në çdo proces gjyqësor të parashikuar ose kryerjen e çdo hulumtimi të kryer, Komisioni do të ndërmarrë çdo hap që ai e gjykon të nevojshëm për të parandaluar çdo vonesë ose degradim të këtij hulumtimi ose procedimi gjyqësor.

4. Komisioni mund të kërkojë nga çdo person, që në përputhje me kërkesat në kuptim të këtij neni dhe që paraqitet para tij, të bëjë betimin ose të bëjë një konfirmim, sipas detajeve të përcaktuara në Rregulloren e Punës së Komisionit.

5. Asnjë person tjetër përveç një komisioneri, personeli të Sekretariatit ose ndonjë person i kërkuar për të hartuar apo prodhuar ndonjë dokument apo gjësend tjetër ose për të dhënë prova, nuk ka të drejtë ose nuk i lejohe të marrë pjesë në çfarëdo hulumtimi të kryer në kuptim të këtij neni. Komisioni mund, duke pasur parasysh parimet e hapjes dhe transparencës, të deklarojë se çdo dokument ose gjësend tjetër, i hartuar apo prodhuar ose informacion i furnizuar në këtë hulumtim, nuk do të bëhet publik derisa Komisioni të përcaktojë ndryshe ose, në mungesë të një përcaktimi të tillë, deri sa të hartohet apo prodhohet dokumenti apo gjësendi tjetër ose informacioni të jetë i dorëzuar në një seancë në kuptim të këtij akti normativ, ose në çfarëdo procesi gjyqësor në cilëndo gjykatë.

6. Komisioni, me qëllim të përmbushjes së mandatit të tij, mund të vizitojë dhe duhet të ketë qasje në çdo institucion, vend apo ndërtesë.

7. Policia e Kosovës, sipas nevojës dhe me kërkesë të bërë nga Komisioni, i siguron Komisionit shërbim dhe ndihmë.

8. Njësia përkatëse e Komisionit, në lidhje me hulumtimet dhe dëgjimet, siguron ekspertizën dhe lehtësitë e nevojshme për të ndihmuar Komisionin, në pajtim me standardet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 43**

#### **Të drejtat e personit të implikuar i cili paraqitet para Komisionit**

1. Nëse gjatë ndonjë hulumtimi nga ose gjatë një seance dëgjimore para Komisionit, një person është implikuar në një mënyrë që mund të jetë në dëm të tij/saj apo kur Komisioni konstaton një

gjetje ose rekomandim i cili mund të jetë në dëm të një personi që është implikuar apo duket se një person mund të jetë viktimë, atëherë Komisioni i jep mundësi atij personi që të:

1.1. paraqesë përfaqësimin në Komision brenda një periudhe kohore të caktuar dhe të arsyeshme në lidhje me çështjen në shqyrtim, dhe

1.2. paraqitet në një seancë dëgjimore të Komisionit, dhe të drejtën që të përfaqësohet ligjërisht, të dëshmojë, ofrojë prova dhe të paraqesë çdo dokument apo objekt që do të merret në konsideratë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Akt dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Kur një person i implikuar i jep Komisionit informacion të besueshëm kontradiktor ose shfajësues, Komisioni do të ndër marrë hapa të arsyeshëm për të hulumtuar informacionin e tillë para se të bëjë një konstatim.

3. Dështimi i një personi të implikuar për të paraqitur përfaqësime në Komision për sa i përket nën paragrafit 1.1. të këtij neni, nuk do të jetë pengesë për Komisionin që të bëjë një konstatim të dëmshëm për të, kur Komisioni ka ndër marrë hapa të arsyeshëm për të informuar një person të tillë dhe t'i sigurojë atij ose asaj një mundësi të arsyeshme për të bërë përfaqësime.

4. Secili person që intervistohet nga një njësi hulumtimi dhe çdo person që është përgjigjur ose është ftuar të paraqitet para Komisionit, informohet paraprakisht për të drejtën e tij/saj për t'u përfaqësuar nga një përfaqësues ligjor i cili ka të drejtë të paraqitet me të autorizuarin apo përfaqësuesin ligjor. Emërimi i një përfaqësuesi ligjor nuk e justifikon personin për të mos u paraqitur para Komisionit personalisht.

5. Komisioni, për të përshpejtuar procedurat, mund të vendosë kufizime të arsyeshme në lidhje me kohën e lejuar për intervistimin dhe drejtimin e dëshmitarëve ose ndonjë prezantim në Komision dhe mund të nxjerrë udhëzime praktike detyruese në këtë drejtim.

6. Komisioni mund të caktojë një përfaqësues ligjor, të paraqitet në emër të personit në fjalë nëse është i bindur që personi nuk ka mundësi financiare të sigurojë vetë një përfaqësues ligjor, dhe nëse është i mendimit se është në interes të drejtësisë që personi të përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor.

#### **Neni 44**

##### **Mbrojtja e dëshmitarëve**

1. Komisioni, në bashkëpunim dhe konsultim me autoritetet përkatëse shtetërore, në pajtim me legjislacionin në fuqi, siguron që të nxirret rregullore për programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

2. Derisa të jetë krijuar programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, Komisioni mund të përcaktojë masa të përkohshme që duhen ndjekur në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen dhe sigurinë e një dëshmitari.

## **KAPITULLI VI - BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN**

### **Neni 45**

#### **Bashkëpunimi i Komisionit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare**

1. Për realizimin e funksioneve të tij Komisioni bashkëpunon me:

1.1. institucione shkencore dhe akademike të arsimit të lartë, institute shkencore, entitete ekonomike, agjenci shtetërore si dhe me punëtorë e hulumtues shkencorë nga fushat e ndryshme të shkencës dhe të artit;

1.2. Institucionet vendore dhe të huaja;

1.3. organizatat dhe shoqatat vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave të personave të pagjetur dhe familjarëve të tyre si dhe me mbrojtjen e të drejtave të kategorive tjera të dala nga lufta.

2. Komisioni bashkërendon aktivitetet me institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe akterët tjerë, në lidhje me ndërtimin e muzeut, monumentit, memorialit apo nismat tjera që kanë të bëjnë me nderimin e viktimave për periudhën që është në shqyrtim.

### **Neni 46**

#### **Bashkëpunimi me akterë ndërkombëtarë dhe me OJQ**

1. Komisioni, përmes memorandumeve të bashkëpunimit, siguron mbështetjen dhe ndihmën e akterëve ndërkombëtarë dhe të Organizatave Joqeveritare (OJQ-ve), e cila përfshin por nuk kufizohet në:

1.1. Ofrimin e ekspertizës në lëmenj të veçantë;

1.2. Sigurimin e informacioneve krahasuese;

1.3. Sigurimin e qasjes në shënimet e veta, dëshmi të mbledhura paraprakisht dhe ndihma nëpërmjet paraqitjes hartografike të rajoneve gjeografike, në mënyrë që komisioni t'i përqendrojë më saktësisht hulumtimet dhe marrjen e deklaratave;

1.4. Organizimin e trajnimeve;

1.5. Njohjen e personave kyç për kontakte;

1.6. qasje në dokumente arkivore të qeverive të huaja;

1.7. Lobimin, me qëllim të zbatimit të politikave ose të procedurave më të qëndrueshme të mundshme lidhur me komisionin;

1.8. Analizën dhe këshillat ligjore që kanë të bëjnë me çështje të ndërlikuara operative e politike, në të cilat komisioni has gjatë punës së vet;

1.9. Konsultimin e ekspertëve të huaj;

1.10. Kontraktimin për ofrimin e shërbimeve ndihmëse.

2. Institucionet shtetërore obligohen të mbështesin Komisionin në ndërtimin e marrëdhënieve bilaterale me shtete tjera me qëllim të sigurimit të ndihmës ndërkombëtare për funksionimin e Komisionit dhe shpërndarjen/zbatimin e rekomandimeve të dala nga puna e Komisionit.

#### **Neni 47**

#### **E drejta për të kontribuar në punën e Komisionit**

Secili person gëzon të drejtën, në përputhje me këtë akt normativ dhe Rregulloren e Punës së Komisionit, të kontribuojë në punën e Komisionit, nëse Komisioni vlerëson se një gjë e tillë do të ndihmojë në realizimin e qëllimeve të tij.

### **KAPITULLI VII – RAPORTI I KOMISIONIT**

#### **Neni 48**

#### **Raporti i Komisionit**

Raporti përfundimtar i Komisionit është trashëgimia më e qëndrueshme e punës së Komisionit dhe duhet të përmbledhë të gjeturat dhe rekomandimet e tij.

#### **Neni 49**

#### **Gjetjet e Komisionit**

1. Komisioni, sipas dispozitave të këtij akti normativ, mund të nxjerrë konstatime që kanë të bëjnë me çdo çështje që është në mandatin e tij.

2. Komisioni nxjerr të gjitha konstatimet pasi t'i ketë vlerësuar kujdesshëm të gjitha gjetjet e propozuara nga secili organ.

3. Komisioni duhet të përdorë një standard të balancimit të mundësive për të konstatuar çdo gjetje, duke përfshirë edhe gjetjet për përgjegjësinë individuale.

4. Gjetjet e Komisionit precizohen në raportin përfundimtar të Komisionit i cili pasqyron faktet e plota mbi të cilat bazohet secili konstatim, së bashku me analizën e Komisionit për faktet e tilla dhe arsyet për secilën gjetje.

5. Komisioni do të përpilojë një përmbledhje të gjetjeve të hollësishme në lidhje me të gjitha çështjet lëndore, referuar si gjetjet kryesore, në një kapitull të gjetjeve, i cili do të jetë pjesë e raportit përfundimtar.

6. Secili komisioner mund të mos pajtohet me gjetjet e komisionerëve të tjerë, por kjo duhet arsyetuar me argumente.

7. Gjetjet e shumicës së komisionerëve, përbëjnë bazën e rekomandimeve të Komisionit, rekomandime që synojnë adresimin e problemeve dhe të mangësive të shpalosura nga gjetjet.

#### **Neni 50**

#### **Rekomandimet e Komisionit**

1. Komisioni, sipas dispozitave të këtij akti normativ, mund të bëjë çdo rekomandim që ka të bëjë me çdo çështje që është në mandatin e tij.



2. Komisioni do të bëjë rekomandime që:

2.1. adresojnë shkaqet e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare;

2.2. adresojnë nevojat e ndryshme të viktimave, kategorive të viktimave dhe të të mbijetuarve;

2.3. shërbejnë për të promovuar rimëkëmbjen dhe pajtimin shoqëror në nivel shtetëror, komunitar dhe individual;

2.4. merret me çdo çështje të pazgjidhur që rrjedh nga puna e Komisionit që kërkon veprim të mëtejshëm.

3. Gjatë dhënies së rekomandimeve të tij, Komisioni:

3.1. propozon masat e nevojshme institucionale, administrative, legislative, kushtetuese dhe / ose masa të tjera që duhet të ndërmerren për të arritur objektivat e rekomandimeve;

3.2. kërkon parashtrësia dhe propozime për rekomandime, nga të gjithë personat e interesuar dhe palët në shoqërinë e Republikës së Kosovës, përfshirë ata persona dhe palët që paraqiten para tij, ose para ndonjë prej komisioneve të tij, dhe Komisioni do t'iu kushtojë vëmendje të duhur parashtrësive dhe propozimeve të tilla;

3.3. mund të thërrasë seanca dëgjimore të veçanta ose ndërmerr hulumtime specifike me qëllim të kërkimit të të dhënave, informacionit dhe këshillave të ekspertëve për çështje apo tema mbi të cilat dëshiron të japë rekomandime.

3.4. do të identifikojë problemin ose çështjen që rekomandimi ka për qëllim ta adresojë dhe të tregojë se si rekomandimi do të shërbejë për ta adresuar problemin ose çështjen;

3.5. do të sigurojë që secili rekomandim të përmbajë sqarime specifike, orientim dhe udhëzim të mjaftueshëm për t'i mundësuar palës së cilës i drejtohet ta zbatojë në mënyrë të arsyeshme rekomandimin e tillë;

3.6. të theksojë afatin kohor të zbatimit të rekomandimit, duke marrë në konsideratë specifikën konkrete

4. çdo rekomandim do t'u drejtohet përgjegjësit të veçantë të zyrës, organit të shtetit, organizatës lokale ose ndërkombëtare, ose një shteti.

5. Bazuar në konkluzionet e Komisionit, që dalin nga hapat e ndërmarrë në këtë nen, së bashku me një shqyrtim të plotë të gjetjeve dhe konkluzioneve të Komisionit, që dalin nga hulumtimet e veta, Komisioni bën rekomandime të cilat do të pasqyrohen në raportin përfundimtar.

6. Rekomandimet e Komisionit duhet të jenë të zbatueshme dhe gjatë dhënies së rekomandimeve duhet marrë parasysh burimet, aftësitë dhe faktorët e tjerë në dispozicion, të Kosovës;



## **Neni 51**

### **Përmbajtja e Raportit përfundimtar**

1. Raporti përfundimtar, në pajtim me detyrat e Komisionit, duhet së paku të përmbajë:
  - 1.1. listën e humbjeve në njerëz (personat civilë të cilët kanë humbur jetën si pasojë e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut, shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe personat e armatosur/Ushtarët në konfliktet e armatosura të cilët kanë humbur jetën).
  - 1.2. listën e personave të zhdukur; dhe
  - 1.3. bazën e të dhënave për komunitetet e viktimave të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut dhe shkeljes së të drejtës humanitare ndërkombëtare ;
  - 1.4. bazën e të dhënave për dëmet ekonomike në Kosovë dhe shkatërrimin e pronës kulturore.
2. Raporti përfundimtar rekomandon së paku masat që kanë të bëjnë me:
  - 2.1. parandalimin e përsëritjes së rrethanave shoqërore dhe politike si në të kaluarën;
  - 2.2. mënyrën e zgjedhjes së reparacionit;
  - 2.3. Mënyrën e zgjidhjes së problemit të personave të zhvendosur;
  - 2.4. Hapat e mëtejme drejt avancimit të mirëbesimit në mes qytetarëve të Republikës së Kosovës;
  - 2.5. Hapat e mëtejme drejt avancimit të mirëbesimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë;
  - 2.6. mënyrën për reformimin institucional;
  - 2.7. mekanizmat me të cilët sigurohen integriteti dhe validiteti i fakteve të vërtetuara në raport, në sistemin e arsimit të Republikës së Kosovës;
  - 2.8. Mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, dhe që mund të përfshijë edhe propozimin për themelimin e mekanizmit të veçantë për realizimin e qëllimit të tillë.

## **Neni 52**

### **Publikimi i Raportit Përfundimtar**

1. Kryekomisioneri, pas përfundimit të periudhës operative, do t'i paraqesë në gjuhët zyrtare, udhëheqësit të institucionit themelues, Raportin Përfundimtar dhe këtë raport do ta publikojë në ueb-faqen e Komisionit.
2. Brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Raportit Përfundimtar, institucioni themelues e dërgon për publikim në Gazetën Zyrtare.
3. Udhëheqësi i institucionit themelues e paraqet Raportin Përfundimtar në Kuvend brenda njëzet e një dite pas publikimit në Gazetën Zyrtare dhe Kryetari i Kuvendit do të organizojë një seancë

të veçantë të Kuvendit për të shqyrtuar dhe debatuar për gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të raportit.

### **Neni 53**

#### **Shpërndarja e raportit**

1. Në mënyrë që raporti përfundimtar të jetë më i kuptueshëm si dhe më i përshtatshëm për shpërndarje të gjerë, Komisioni duhet të përgatisë edhe një:
  - 1.1. raport më të shkurtër përmbledhës i cili duhet të përkthehet në të gjitha gjuhët që janë në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe gjuhën angleze dhe sipas mundësive edhe në gjuhët tjera;
  - 1.2. libër të veçantë me fotografi që i dokumenton shkeljet, dhe ta publikojë atë;
  - 1.3. video-version të raportit, të cilin e përgatit vetë apo në bashkëpunim me institucione të tjera;
  - 1.4. versionin “miqësor për fëmijë”, të raportit të tij përfundimtar;
2. Komisioni mund të organizojë Koloni Artistike, ku artistë vendorë e ndërkombëtarë zhvillojnë ide për paraqitjen e të gjeturave përmes artit në raport me kohën e hulumtuar nga Komisioni, si dhe forma tjera kulturore dhe sportive.
3. Komisioni siguron që raporti i shkurtër përmbledhës të botohet edhe në gazetën vendore me tirazh të madh.
4. Komisioni duhet të ndër marrë masat që raporti përfundimtar të këtë një shpërndarje sa më të gjerë të të gjitha institucionet, qofshin vendore apo ndërkombëtare.

### **Neni 54**

#### **Përfundimi i punës së Komisionit**

1. Pas publikimit të raportit përfundimtar, Komisioni përfundon punën në një afat më së gjati prej tre muajsh.
2. Në atë periudhë kohore ndërmerren masat e sistematizimit, ndarjes dhe ruajtjes së arkivit, ndarjen e pronës, përbushjes së obligimeve ndaj personave të tretë, distribuimit dhe prezantimit të raportit përfundimtar, si dhe hartimit të raporteve financiare dhe raportimin e punës së Komisionit.

### **Neni 55**

#### **Vazhdimi i punës dhe Zbatimi i rekomandimeve të Komisionit**

1. Pasi Komisioni ta këtë dorëzuar raportin e vet përfundimtar dhe pasi të jetë shpërbërë zyrtarisht, detyra e përbushjes së rekomandimeve të tij duhet të ndërmerret nga një njësi përkatëse e qeverisë, e ngarkuar me detyrën e zbatimit dhe koordinimin e zbatimit të rekomandimeve.

2. Komisioni mund t'i propozojë Qeverisë njësinë përkatëse për përmbushjen e rekomandimeve të tij.
3. Komisioni i propozon Qeverisë një strukturë për përmbushjen e rekomandimeve të tij ose një trup i cili e monitoron zbatimin dhe përforcon objektivat e këtij Akti nëpërmes ruajtjes së kujtesës dhe edukimit publik.
4. Qeveria do ta konsiderojë seriozisht çdo rekomandim të paraqitur nga Komisioni.
5. Qeveria, brenda gjashtë (6) muajve nga publikimi i Raportit Përfundimtar nga Komisioni, do të specifikojë Planin e Qeverisë për zbatimin e Raportit Përfundimtar duke e botuar në Gazetën Zyrtare:
  - 5.1. rekomandimet specifike të Komisionit që Qeveria synon t'i zbatojë, njësitë përkatëse përgjegjëse për zbatim dhe afatet kohore, si dhe
  - 5.2. arsyet e hollësishme për pamundësinë e Qeverisë për zbatimin e rekomandimeve specifike të Komisionit.
6. Kryetari i Kuvendit do të organizojë një seancë të dytë të veçantë të Kuvendit brenda tridhjetë (30) ditëve nga përgjigja e Qeverisë, sipas paragrafit 5 për të shqyrtuar dhe debatuar për përgjigjen e Qeverisë dhe për të marrë parasysh çdo veprim të mëtejshëm, nëse ka ndonjë veprim që Kuvendi mund të marrë.

## **KAPITULLI VIII – SEKRETARIATI EKZEKUTIV I KOMISIONIT**

### **Neni 56**

#### **Organizimi i Sekretariatit**

1. Nën drejtimin e Drejtorit, në kuadër të Komisionit funksionon Sekretariati, i cili e ndihmon Komisionin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.
2. Në kuadër të Sekretariatit funksionojnë njësitë për mbështetje profesionale, të cilat përbëhen nga njerëz të profilizuar në fushat relevante e të cilët mbështesin në mënyrë të drejtpërdrejtë punën profesionale të Komisionit.
3. Njësitë përkatëse të Sekretariatit do t'i kenë përgjegjësitë dhe funksionet e tyre, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës së Komisionit.
4. Drejtori dhe punonjësit e Sekretariatit i nënshtrohen legjislacionit përkatës në fuqi.

### **Neni 57**

#### **Funksionet e Sekretariatit**

1. Sekretariati ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
  - 1.1. ofron mbështetje profesionale, teknike, administrative dhe operative për Komisionin;
  - 1.2. zbaton të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Komisioni, brenda kornizës së buxhetit të caktuar;

- 1.3. përgatit propozimin për buxhetin vjetor të Komisionit të cilin ia paraqet Komisionit për miratim;
- 1.4. administron buxhetin e miratuar të Komisionit;
- 1.5. sipas udhëzimeve të Komisionit harton aktet, raportet, hulumtimet dhe shkresat që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Komisionit dhe zbatimin e këtij akti normativ;
- 1.6. është përgjegjës për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Komisionit.

## **Neni 58**

### **Drejtori i Sekretariatit**

1. Drejtori i Sekretariatit:
  - 1.1. është zyrtari kryesor administrativ;
  - 1.2. iu raporton Komisionit dhe Kryekomisionerit;
  - 1.3. është përgjegjës për krijimin dhe administrimin e sistemeve administrative, financiare, logjistike dhe personelit të Sekretariatit;
  - 1.4. siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të Komisionit në mënyrë efikase dhe efektive;
  - 1.5. është përgjegjës ndaj Komisionit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit;
  - 1.6. merr pjesë në takimet e Komisionit, pa të drejtë vote dhe u përgjigjet të gjitha kërkesave të Komisionit për informacion;
  - 1.7. është përgjegjës për menaxhimin e nëpunësve në Sekretariat;
  - 1.8. është përgjegjës për menaxhimin me financat dhe me burimet tjera të financimit;
  - 1.9. ofron këshilla të paanshme dhe profesionale për Komisionin;
  - 1.10. është përgjegjës për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e aseteve dhe pasurisë së Komisionit;
  - 1.11. menaxhon rrjedhën e informacionit në Komision;
  - 1.12. bashkëpunon dhe koordinon punët me institucionet tjera, si dhe
  - 1.13. kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të caktuara nga Komisioni, nga ky akt normativ ose ligjet apo aktet tjera nënligjore.

## **Neni 59**

### **Emërimi i Drejtorit**

1. Drejtori, me aftësitë e nevojshme administrative, financiare dhe organizative, përzgjidhet, emërohet dhe shkarkohet, pas një procesi konkurrues, meritohet dhe transparent, në pajtim me këtë akt normativ, Rregulloren e Punës së Komisionit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Dispozitat dhe procedurat e përzgjedhjes, emërimit dhe të shkarkimit të komisionerëve dhe kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e komisionerëve, vlejné përshtatshmërisht edhe për emërimin e Drejtorit.

## **Neni 60**

### **Angazhimi i personelit në Sekretariat**

1. Personeli i Sekretariatit përzgjidhet në kuadër të buxhetit të Komisionit dhe sipas organogramit të miratuar nga Komisioni, nëpërmjet një procesi të hapur dhe konkurrues dhe në pajtim me standardet më të larta të etikës profesionale, si dhe duke siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës.
2. Komisioni dhe Drejtori sigurojnë që përzgjedhja e personelit të Sekretariatit, veçmas atij në pozita të larta, të përfshijë persona me njohuri në punët administrative dhe në menaxhim, si dhe aftësi për të punuar me efektivitet nën tryzni të madhe.
3. Sekretariati angazhon, në disa prej kategorive që përfshihen por nuk kufizohen, ekspertë të drejtave të njeriut, ekspertë ligjorë, hulumtues, psikoterapeutë ose punëtorë socialë, përkthyes, specialistë për punën me kompjuter, personel për futjen e të dhënave, si dhe personel të sigurisë.
4. Personeli i Sekretariatit nënshkruan Deklaratën nën Betim, sipas Rregullores së Punës së Komisionit.
5. Personeli i Sekretariatit përfundon punën e tij jo më gjatë se gjashtë muaj pas publikimit të Raportit përfundimtar.

## **Neni 61**

### **Kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e personelit në Sekretariat**

1. Kriteret e përgjithshme për zgjedhjen e personelit në Sekretariat janë:
  - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
  - 1.4. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
  - 1.5. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga puna;
  - 1.6. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe

1.7. të kalojnë me sukses procedurat e rekrutimit, sipas këtij akti normativ dhe rregullores së Punës së Komisionit.

## **KAPITULLI IX - FINANCIMI I KOMISIONIT**

### **Neni 62**

#### **Burimet e financimit të Komisionit**

1. Puna e Komisionit financohet nga:
  - 1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Donacionet dhe
  - 1.3. Burimet e tjera të ligjshme.
2. Komisioni mund të marrë kontribute nga donatorët dhe nga burimet tjera të ligjshme, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe ato nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë e Komisionit.
3. Komisioni, për t'i përmbushur qëllimet e tij, përgatit një plan të grumbullimit të fondeve.
4. Për kontributet e donatorëve dhe burimeve tjera që pranohen, duhet të njoftohet udhëheqësi i institucionit themelues.

### **Neni 63**

#### **Buxheti i Komisionit**

1. Komisioni harton buxhetin vjetor, në pajtueshmëri me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
2. Në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit, dhe me qëllim të garantimit të pavarësisë, buxheti vjetor i Komisionit rrjedh nga buxheti vjetor i institucionit themelues, ka vijën e vet buxhetore, gjegjësisht nën-kodin buxhetor, dhe këto mjete i lejohen për shfrytëzim pas një plani paraprakisht të përgatitur për zhvillimin e aktiviteteve të rregullta vjetore të tij.
3. Buxheti i Komisionit duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar zbatimin e mandatit, funksionimin e plotë dhe të efektshëm të Komisionit, grupeve të tij punuese dhe Sekretariatit.
4. Institucioni themelues, me rastin e propozimit të shumës së buxhetit vjetor, duhet të marrë parasysh propozimet e Komisionit dhe duhet të përkrahët dhe t'i jepet një mundësi e përshtatshme për të mbrojtur buxhetin e Komisionit para institucioneve përkatëse.
5. Komisioni menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin e saj vjetor. Drejtori mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe auditimeve financiare, duke pasur parasysh ligjet e aplikueshme mbi menaxhimin e financave publike.
6. Shpenzimi i buxhetit të Komisionit i nënshtrohet auditimit të brendshëm si dhe auditimit të jashtëm nga Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës.

7. Komisionerët dhe personeli i Sekretariatit, japin përgjegjësi penale dhe administrative sipas legjislacionit në fuqi, nëse i shkelin dispozitat e legjislacionit në fuqi për shpenzimin e parasë publike.

## **KAPITULLI X - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE**

### **Neni 64**

#### **Mbështetja për themelimin e Komisionit**

1. Në fazën fillestare, Institucioni themelues i siguron Komisionit hapësirë për zyrë, e cila duhet të jetë e ndarë nga zyrat e institucionit themelues, pajisje të zyrës, mjete të transportit dhe gjëra tjera të nevojshme.

2. Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, i emëruar nga Presidenti me Vendimin Nr. 61/2018, të datës 27.04.2018, dhe Sekretaria e Ekipit ndihmojnë në themelimin e Komisionit dhe trupave përkatëse.

### **Neni 65**

#### **Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit**

1. Refuzimi për të bashkëpunuar me Komisionin nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Komisioni të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna.

2. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hulumtimit Komisioni ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

### **Neni 66**

#### **Imuniteti funksional**

Asnjë komisioner, anëtar i stafit të Sekretariatit, ose ndonjë person tjetër që vepron në emër të Komisionit, nuk do të mbajë përgjegjësi penale ose civile në lidhje me kryerjen e detyrave të punës në komision përveç nëse bie ndesh me ligjet në fuqi.

### **Neni 67**

#### **Dosjet e Komisionit**

1. Komisioni, që në fillim të punës së tij, definojnë metodologjinë e arkivimit, digjitalizimit, grumbullimit të të dhënave dhe duke pasur parasysh parimin e ruajtjes së informatave të ndjeshme. Për këtë qëllim konsultohet edhe me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

2. Sekretariati, sipas metodologjisë përkatëse, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni në vazhdimësi arkivon dhe digjitalizon dokumentacionin e mbledhur të Komisionit, duke hartuar një plan për shfrytëzim afatgjatë .

3. Komisioni themelon Arkivin e Komisionit, që duhet të përmbajë por nuk kufizohet në deklarata dhe dosje të tjera të hulumtimit të nevojshme për përgatitjen e raportit përfundimtar dhe me qëllim të referimit të mundshëm edhe në të ardhmen.

4. Lënda arkivore dhe baza e të dhënave të Komisionit, pas pushimit të punës së Komisionit, janë të hapura për qasje të pakufizuar ndaj të gjitha institucioneve të interesuara dhe personave, përveç dokumentacionit i cili i nënshtrohet obligimit për ruajtjen e sekretit të të dhënave.

5. Më së paku tridhjetë (30) ditë para përfundimit të punës së Komisionit, Sekretariati u dorëzon kopjet e lëndës së unifikuar arkivore dhe bazës së të dhënave, Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

## **Neni 68**

### **Veprimet e Komisionit para përfundimit të mandatit të Komisionit**

1. Komisioni shpërndahet pas përfundimit të mandatit dhe para se Komisioni të shpërndahet, Komisionerët organizojnë:

1.1. bartjen, e pronës së mbetur të Komisionit në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.2. inventarizimin e detajuar të të gjitha regjistrave dhe materialeve të tij;

1.3. arkivat për referencë në të ardhmen, duke i kushtuar vëmendje të veçantë:

1.3.1. cilat materiale ose informacione mund të vihen në dispozicion të publikut menjëherë ose kur kushtet dhe burimet lejojnë;

1.3.2. cilat masa mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur informacionin konfidencial;

1.3.3. transferimit të të gjitha regjistrave dhe materialeve të Komisionit në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

## **Neni 69**

### **Sigurimi i punës pas përfundimit të mandatit**

1. Pas përfundimit të mandatit, anëtari i Komisionit mund të kthehet në funksionin e tij/saj ose punën publike që kishte para zgjedhjes si anëtar i Komisionit. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë punëdhënësi i mëhershëm duhet t'i sigurojë një punë të paktën në nivelin e njëjtë, dhe që do të gëzonte pagën e barasvlershme me atë që kishte para zgjedhjes si anëtar i Komisionit.

2. Anëtarit të Komisionit, të cilit i përfundon mandati, ose që për shkaqe të arsyeshme nuk mund ta vazhdojë punën e mëparshme ose nuk mund të gjejë punë tjetër adekuate, e as që i ka plotësuar kushtet e përgjithshme të pensionimit, gëzon të drejtën e pagës në vlerën e pagës së fundit të pranuar, por jo më gjatë se një (1) vit nga përfundimi i mandatit.

## **Neni 70**

### **Rregullorja e Punës dhe aktet tjera të Komisionit**



1. Komisioni, në pajtim me këtë akt normativ, më së largu brenda tre (3) muajsh pas mbajtjes së mbledhjes themeluese, miraton Rregulloren e Punës, me të cilin përcaktohen procedurat dhe mënyra e funksionimit të Komisionit dhe Sekretariatit, me qëllim të arritjes së objektivave të veta.
2. Rregullorja e Punës së Komisionit bëhet publike në Gazetën Zyrtare.
3. Komisioni, brenda periudhës më së largu prej gjashtë (6) muajsh, pas mbajtjes së mbledhjes themeluese, harton dhe miraton dokumentet tjera relevante që rregullojnë funksionimin e brendshëm, vendimmarrjen dhe administrimin e Komisionit, në pajtim me këtë akt normativ.
4. Komisioni mund të nxjerrë udhëzues, me të cilat rregullohet metodologjia unike për:
  - 4.1. marrjen e deklaratave;
  - 4.2. hulumtimin dhe mbledhjen e dokumenteve;
  - 4.3. rregullimin e procedurave për dëgjime publike;
  - 4.4. rregullimin e sesioneve tematike;
  - 4.5. hartimin e listës së humbjeve në njerëz;
  - 4.6. hartimin e listës së humbjeve ekonomike;
  - 4.7. komunikimin dhe studimin në terren;
  - 4.8. raportimin;
  - 4.9. rekrutimin dhe verifikimin e stafit;
  - 4.10. politikat e informacionit dhe sigurisë fizike;
  - 4.11. konfidencialitetin e informatave;
  - 4.12. menaxhimin e ankesave;
  - 4.13. mbajtjen e shënimeve;
  - 4.14. dëshmitë dhe procedurat për mbrojtjen e dëshmitarëve;
  - 4.15. njoftimin për deklarata të dëmshme;
  - 4.16. pajtimin dhe ndërmjetësimin;
  - 4.17. gjetjet e përgjegjësisë individuale, si dhe
  - 4.18. çështjet tjera që i konsideron të nevojshme.

5. Udhëheqësi i institucionit themelues, në konsultim me Ministrin e Financave, mund të nxjerrë rregullore:

- 5.1. që përcakton shpërblimin, kompensimet dhe përfitimet tjera, nëse ka, të:
  - 5.1.1. komisionerëve, me kusht që pagesa e tillë të mos jetë më e vogël se ajo e një gjykatësi të Gjykatës Supreme, si dhe
  - 5.1.2. personelit të Sekretariatit;
- 5.2. duke parashikuar pagesën ose rimbursimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me udhëtimin dhe akomodimin nga personat që marrin pjesë në çdo dëgjim të Komisionit në përputhje me një ftesë ose thirrje të lëshuar në kushtet e këtij Akti;
- 5.3. që përshkruan çdo gjë që kërkohet të përshkruhet për zbatimin e duhur të këtij akti.

#### **Neni 71**

##### **Publikimi në Gazetën Zyrtare**

Ky akt normativ publikohet në Gazetën Zyrtare.

#### **Neni 72**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Prishtinë, \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .